



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 6111..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 15 / 02 / 2021

VENDIM
Nr.14, date 15 /02 /2021

**NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR OPINION PËR PROJEKT ZBATIMET E STRUKTURAVE
TË BANIMIT DHE SHËRBIMIT NË RRUGËN DORA D'ISTRIA, TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 278, datë 08.05.2003 "Për Miratimin e Rregullores së funksionimit të Komitetit Kombëtar të digave të mëdha dhe të Keshillit Teknik të perhershëm të digave (KTPD)", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) pasi shqyrtoi kërkesën për opinion për Projekt zbatim të strukturave të banimit dhe shërbimit në rrugën Dora D'Istria, Tiranë.

VENDOSI:

- 1- Të mos e shqyrtoje kërkesën për Opinion të projekt zbatimeve të strukturave të banimit dhe shërbimit në rrugën Dora D'Istria në Tiranë duke sqaruar Kerkuesit se bazuar në Ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, pika dh, KKDM miraton projektet –idete dhe projekt zbatimet e digave të reja si dhe projektet e riparimit dhe përmirësimit të digave që janë në shfrytëzim; **Për rrjedhojë duke u bazuar në legjislacionin e mësipërm, KKDM nuk ka kompetenca ligjore të shqyrtojë projekte për objekte që nuk janë pjesë e riparimit apo përmirësimit të digës së liqenit të Tiranës që aktualisht është në shfrytëzim.**
- 2- Bazuar në Ligjin nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", dhe të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për miratimin e Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Pronari ose shfrytëzuesi i objektit (Bashkia Tiranë) sëbashku me projektuesin, mund të paraqesë në KKDM për miratim teknik projektidënë ose projektin e zbatimit për ndërtimin ose rehabilitimin e cdo dige që shfrytëzohet prej tyre. Projekti duhet të përgatitet sipas kërkesave të Rregullores për Sigurinë e digave dhe dambave, neni 7,8,9 dhe të shoqërohet me studimet mbështetëse dhe dokumentacionin e duhur teknik sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje.
- 3- Në lidhje me faktin e përmendur nga ana e Kerkuesve për Opinion për raste të ngjashme ku është marrë miratimi me shkrim nga ana e KKDM, të informohen Kerkuesit e Opinioni se KKDM në asnjë rast nuk ka marrë në shqyrtim ndonjë objekt banimi dhe shërbimi në këtë zonë. I vetmi rast që është shqyrtuar nga KKDM në këtë zonë është rasti i një Studimi Hidroteknik për sigurinë e Digës së Liqenit Artificial të Tiranës në vitin 2014 i kryer nga një subjekt privat. Shqyrtimi i këtij rasti është konstatuar i pavlefshëm me Vendim të KKDM nr. 04, datë 06.01.2015 për arsye se studimi i paraqitur nuk ka patur objekt riparimit apo përmirësimit të digës si dhe për faktin se shqyrtimi i këtij studimi nga ana e KKDM ishte në kundërshtim me ligjin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Vendimi i mesiperm sëbashku me Relacionin shpjegues i është përcjellë zyrtarisht Bashkisë Tiranë dhe organeve të tjera përkatëse.

- 4- Te njoftohet menjehere Bashkia Tirane dhe institucionet perkatese lidhur me kete Vendim
- 5- Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyre ekzekutive e KKDM të ndjekë procesin e zbatimit te ketij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

